

Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 - 2009



Botuar nga: UNDP Kosovë

Këtë studim e inicoi UNDP në Kosovë dhe Qendra Rajonale e UNDP-së në Bratislavë.

Dizajni dhe përgatitja: www.xhad.net

Shtypur nga: Grafika Reznici

Mohim: Qëndrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Parathënie në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka nderin që ka hartuar Regjistrin e parë të Gazeve Serrë për mbarë Kosovën, i cili do të përfshijë të gjitha gazet serrë që prodhohen në Kosovë. Ministria është mirënjohëse për ndihmën kolegjiale të ekipit të ekspertëve nga Çekia, të cilët i prezantuan Metodatat e Regjistrimit të Gazeve Serrë për homologët e tyre kosovarë. Gjithashtu, në emër të Ministrisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mjedisor të Kosovës, Ministria shpreh komplimentet për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Qeverisë Çeke, që mundësuan Regjistrin e Gazeve Serrë, me kontributet e tyre financiare dhe operative.

Pasi që Kosova është duke u zhvilluar për të qënë në hap me ekonominë e tregut evropian, kjo nënkupton edhe një rol më vendimtar për menaxhimin e mjedisit të Kosovës, për të garantuar zhvillimin e vendit me hapa të qëndrueshëm. Për momentin, emetimet e gazeve serrë në Kosovë janë relativisht të ulëta, në krahasim me vendet e tjera të Evropës. Megjithatë, zhvillimi industrial që po ndodh në Kosovë, së bashku me urbanizimin dhe rritjen e numrit të popullatës, do të ndryshojë emetimin e gazeve me efekt në ndryshime klimatike në Kosovë. Për t'iu bashkuar përpjekjeve globale për zvogëlimin dhe kufizimin e efekteve të dëmshme të ngrohjes globale, Kosova ka nevojë për mbikqyrjen dhe menaxhimin e gazeve të veta serrë.

Sistemi i menaxhimit të gazeve serrë (GHG) do të menaxhohet nga Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe do të përdoret për t'u raportuar organeve të brendshme dhe të jashtme, për politikën e zhvillimit, debatet e politikave dhe politikën e mbikqyrjes. Në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare gjithnjë e më sfiduese për zvogëlimin e emetimeve dhe masave për zhvillimin e gjelbërimit, përdorimi i Regjistrimit GHG në Kosovë vjen në kohë të duhur dhe do të mbështesë synimet e Kosovës për zhvillimin e gjelbërimit dhe kontributin e tij për agjendën ndërkombëtare të ndryshimeve klimatike.

Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mjedis, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Prishtinë 2012



Parathënie në emër të ekipit të ekspertëve për Regjistrin e Gazeve Serrë nga Çekia

Raporti 2007/2008 i UNDP-së për Zhvillimin Njerëzor vlerëson se stabilizimi i koncentrimit të gazeve serrë (GHG) në atmosferë, në një nivel që parandalon ndikimin nga ndryshimet klimatike, kërkon 50% zvogëlim të emetimit të GHG deri në vitin 2050, për të ardhur në nivelin e viteve 1990. Kjo është relevante sidomos për rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili ka disa nga ekonomitë më intenzive me karbon, dhe ndryshimi i klimës tanimë ka ndikim të sertë në zhvillim. UNDP, si agjenci implementuese me mandat për zhvillimin dhe klimën, ka prioritet të lartë zhvillimin e kapaciteteve për vendet, në mënyrë që ato të mund të formulojnë strategjitë, të kenë qasje në fonde dhe të implementojnë startegjitë zhvillimore me emetim të vogla.

Lidhur me këto nevoja urgjente, UNDP shpalli thirrjen për projekte të titulluar “Transferimi i përvojës çeke: Hartimi i Sistemit për Menaxhimin e Regjistrin të Gazit Serrë (GHG) në Kosovë”. Grupi i ekspertëve çekë që e përbëjnë Sistemin aktual të Çekisë për Regjistër Nacional (NIS) formuan një grup të udhëhequr nga Qendra për Mjedis e Universitetit Çarls (Charles) dhe iu përgjigjën kësaj thirrjeje me sukses. Synimet kryesore të projektit ishin të shkohet në Kosovë dhe të trajnohen ekspertët e vendit për mënyrën e zbatimit të metodologjive të Regjistrin GHG në kushte nacionale. Një synim tjetër i projektit ishte vlerësimi i emetimeve GHG nga të gjitha aktivitetet antropogjene, sipas metodologjisë IPCC 2006 (Paneli Ndërqeveritar për Ndryshime Klimatike) dhe prezantimi i këtyre rezultateve për një forum nacional. Broshura që e keni përpara përmban rezultatet e Regjistrin GHG për vitet 2008 dhe 2009. Të gjitha supozimet dhe metodat themelore dhe të dhënat që qëndrojnë prapa rezultateve janë të përshkruara më hollësisht në një dokument të veçantë.

Kosova nuk është pjesë e UNFCCC-së (Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike) apo Protokolit të Kiotos. Megjithatë, Qeveria e Kosovës, ngjashëm me BE-në, konsideron ndryshimin e klimës si fushë prioritare dhe është përkushtuar në dhënien e kontributit të vet për zgjidhjen e kësaj sfide globale. Pasi që rezultatet e Regjistrin GHG u zhvilluan në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe të Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, këtë projekt e konsiderojmë si hap të parë tejet të rëndësishëm për popullin e Kosovës, në rrugën drejt përmirësimit të ndryshimit të klimës.

Miroslav Havránek, Pragë 2012



Contents

Emetimi i përgjithshëm nga aktivitetet njerëzore në Kosovë	6
Sektor 1: Energjia	10
Sektor 2: Proceset industriale dhe shfrytëzimi i produkteve	12
Sektor 3: Bujqësia, Pylltaria dhe Përdorimi i Tokës.....	13
Sektor 4: Mbeturinat	15



Emetimi i përgjithshëm nga aktivitetet njerëzore në Kosovë

	Emetime (miliona. tonelata CO ₂ eq.)	
	2008	2009
GJITHSEJ NË NIVEL NACIONAL	9489.7	10507.2
1 - Energji	7615.2	8590.0
1.A - Aktivitetet e djegies së karburantëve	7578.2	8548.2
1.B - Emetimi i lëndëve të arratisura djegëse	37.0	41.8
1.C - Dioksid karboni Transporti dhe Akumulimi	0.0	0.0
2 - Proceset industriale dhe shfrytëzimi i produkteve	248.6	254.0
2.A - Industria minerale	221.3	217.8
2.B - Industria kimike	0.0	0.0
2.C - Industria e metalit	18.2	16.9
2.D - Produktet jo-energjetike nga Lëndët Djegëse dhe Përdorimi i Tretësve	2.7	1.4
2.E - Industria elektronike	0.0	0.0
2.F - Përdorimet e produkteve të cilat përdoren si zëvendësim për Substancat që Zvogëlojnë Ozonin	4.7	12.6
2.G - Manufakturimi dhe përdorimi i produkteve të tjera	1.7	5.4
3 - Bujqësia, Pylltaria dhe Shfrytëzimi i tokës në mënyra të tjera	1335.0	1370.4
3.A - Bagëtia	586.9	597.2
3.B - Toka	-37.2	-26.3
3.C - Burimet agregate dhe burimet e emetimit të jo-CO ₂ në tokë	785.3	799.5
3.D - Të tjera	0.0	0.0
4 - Mbeturinat	290.8	292.9
4.A - Hedhja e Mbeturinave të Ngurta	202.1	203.7
4.B - Trajtimi biologjik i mbeturinave të ngurta	0.0	0.0
4.C - Djegia dhe djegia e hapur e mbeturinave	0.5	0.5




4.D - Trajtimi dhe lëshimi i ujërave të zeza	88.1	88.6
Kategori të tjera potenciale në të ardhmen		
Bunkerët ndërkombëtarë	0.7	1.0
1.A.3.a.i - Aviacioni ndërkombëtar (Bunkerët ndërkombëtarë)	0.7	1.0
1.A.3.d.i - Navigacion uhor ndërkombëtar (Bunkerët ndërkombëtarë)	0.0	0.0
1.A.5.c - Operacionet multilaterale	0.0	0.0

Emetimet e përgjithshme të të gjitha gazërave serrë në vitin 2008 arritën 9.5 Mt CO₂ eq. Ato u shtuan në 10.5 Mt CO₂ eq. në vitin 2009. Kjo rritje relativisht e madhe u shkaktua pothuajse vetëm nga djegia e shtuar e lëndëve djegëse fosile. Dioksid karboni përbën rreth 80 % të të gjitha emetimeve, ndërsa metani dhe oksidi i azotuar janë të dy rreth 10 %. Të ashtuquajturat gaze të reja serrë, siç janë HFC-të (hidrofluorokarbon) dhe PFC-të (perfluorokarbon), janë pothuajse të papërfillshme.

Spektori më i rëndësishëm për regjistrin e plotë është sektori “1A aktivitetet e djegies të lëndëve djegëse” të cilat përbëjnë rreth 80% të të gjitha emetimeve antropogjene në Kosovë. Kategoria më e rëndësishme e burimeve për Kosovën është djegia e lëndëve të ngurta djegëse. Të ashtuquajturat “kategori kyç” (ato të cilat kumulativisht përbëjnë 95% të emetimit të përgjithshëm) janë të paraqitura në fotografinë e mëposhtme.






Fotografia 1: Kategoritë e emetimeve kyçe në Kosovë, 2009

Kosova, në krahasim me vendet e tjera në Evropë, akoma ka emetim relativisht të ulët per capita. Kjo ndodh kryesisht për shkak të kushteve të favorshme gjeografike dhe për shkak të mungesës së industrive me energji intensive, bujqësisë intensive dhe mungesës së menaxhimit të mbeturinave. Meqenëse parashikojmë që të gjithë këta faktorë të ndryshojnë në të ardhmen dhe ndoshta si rrjedhojë do të shtojnë emetimet, ekziston mundësia e ndjekjes së strategjive të zhvillimit neutral ndaj karbonit.






Krahasimi ndërkombëtar i emetimit GHG, 2009



Sektori 1: Energjia



Sektori energjetik prodhon rreth 82% të emetimit të përgjithshëm nacional të gazeve serrë. Ky sektor përfshin djegjen, eksploatimin dhe transmetimin e lëndëve djegëse fosile në Kosovë. Proceset djegies në industritë energjetike të kategorisë 1A realizojnë kontribut vendimtar për emetimet e përgjithshme të gazeve serrë, sidomos të dioksid karbonit, i cili prodhohet gjatë djegies së lëndëve djegëse në bazë të karbonit. Emetimet nga kjo kategori janë të bazuara pothuajse vetëm në djegjen e lignitit në termocentralet e Kosovës. Në të ardhmen, Kosova duhet të kërkojë mundësi për zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë. Përmirësimi i efikasitetit energjetik të këtij instalimi të rëndësishëm është strategjia e përfitimit të dyanshëm, si për prodhimin e energjisë, ashtu edhe për emetimet e gazeve serrë.

Sektori i transportit është duke u rritur me numrin e shtuar të automjeteve dhe me konsumimin e lëndëve djegëse. Me pasurimin e njerëzve, edhe sis-




temi rrugor do të zhvillohet dhe kjo kategori sigurisht do të ketë rëndësi më të madhe.

Emetimet e ikura që janë të përfshira në kategorinë 1B, vijnë nga eksplorimi, ekspluatimi dhe distribuimi i lëndëve djegëse. Në rastin e Kosovës, ligniti i minierave në Kosovë është relativisht i ri dhe nuk përmban shumë metan. Me industrializimin e vendit në të ardhmen dhe me përdorimin e gazit natyral, kjo kategori mund të rritet si pasojë e rrjedhjes së gazit gjatë transportit.



Sektori 2: Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve




Sektori i industrial i procesimit i dhe përdorimit të produkteve ka gjithsej rreth 250 mijë tonë të CO₂ eq. që përbën rreth 2% të të gjitha emetimeve antropogjene në Kosovë. Ky sektor përfshin emetimin e gazeve serrë që shfaqen nga proceset industriale, nga përdorimi i gazeve serrë në produkte dhe nga përdorimet jo-energjetike të lëndëve djegëse fosile.

Kategoria kryesore në këtë sektor është industria e mineraleve dhe metaleve në Kosovë, e cila në vitin 2009 përfshin rreth 90% të gjithë sektorit. Pjesa më e madhe e industrisë minerale i përket nënkategorisë për prodhimin e çimentos, edhe pse në Kosovë ekziston vetëm një fabrikë e çimentos. Industria kimike dhe ajo elektronike që prodhojnë emetime GHG, nuk janë prezente në Kosovë. Në të ardhmen kjo mund të ndryshojë dhe për zhvillimin e këtyre sektorëve industrial duhet të merren parasysh parimet e zhvillimit me nivel të ulët të karbonit.

Ky sektor përfshin edhe emetimin e substancave, të cilat zëvendësojnë substancat që hollojnë shtresën e ozonit. Këto substanca janë kryesisht pjesë e përdorimit shtëpiak të frigoriferëve, ftohësve me presion të lartë dhe sistemet e lëvizshme apo stabile të kondicionimit të ajrit. Tani këto janë të parëndësishme, por me zhvillimin e vendit, do të ndiqet modeli i vendeve të pasura evropiane.

Sektori 3: Bujqësia, Pylltaria dhe Shfrytëzimi i Tokës



Sektori Bujqësi, Pylltari dhe Shfrytëzimi i Tokës përfshin rreth 13% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë. Ky është sektori i vetëm i kategorisë akumuluese në regjistrin e Kosovës. Përbëhet nga tre nënsektorë të ndryshëm. Nënsektori i parë merret me emetimin nga bagëtia. Ememetimet e metanit nga fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve) dhe emetimet e oksidit të azotuar dhe metanit nga menaxhimi i plehërave janë pjesë e rëndësishme e buxhetit të Kosovës për gazet serrë. Pothuajse 600 mijë tonë CO₂ eq. në vjet prodhohen nga bagëtia.

Nënsektori i dytë merret me ndryshimet e rezervave të karbonit në përdorime të ndryshme të tokës. Ky nënsektor dominohet nga pylltaria, e cila mund të jetë rezervoar i fuqishëm i karbonit atmosferik, mirëpo për shkak të prerjes intensive (dhe shpesh ilegale) të drunjve për ngrohje, ky sektor nuk është i rëndësishëm në Kosovë në aspekt relativ (rreth 40 mijë tonë CO₂ eq.) por në aspekt të karbonit që rrjedh nga ky sektor çdo vjet, përfaqëson sektorin e dytë për nga madhësia në vend (tokat pyjore që mbeten toka pyjore kanë




rreth 275 mijë tonë CO₂). Regjistri i mirë i pyjeve dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në Kosovë do të ishte i dobishëm për zvogëlimin e emetimeve nga vendi në tërësi.

Nësektori i tretë trajton emetimet nga fertilizimi i tokës dhe gjithashtu nga djegia e biomasës. Kategoritë më të rëndësishme janë emetimet indirekte të oksidit të azotuar që lidhen me menaxhimin e plehërave dhe fertilizimin e drithërave. Gjithsej, ky nësektor emeton rreth 800 mijë tonë CO₂ eq.



Sektori 4: Mbeturinat



Sektori i mbeturinave në Kosovë përfshin rreth 3% të emetimeve të përgjithshme nacionale të gazeve serrë. Nënsektori më i rëndësishëm është emetimi nga deponitë. Deponitë në Kosovë nuk i plotësojnë kushtet strikte anaerobe të nevojshme për formimin e metanit. Ky nënsektor prodhon rreth 200 mijë tonë CO₂ eq. në vjet. Nëse deponitë do të plotësonin të gjitha praktikatat sanitare dhe të menaxhimit të mirëfilltë, atëherë potenciali i gjeneratës së metanit do të rritej në nivelin kur është ekonomikisht i përshtatshëm për ta tërhequr dhe për ta shfrytëzuar si lëndë djegëse.

Djedia e mbeturinave pothuajse nuk ekziston në vend. Ka disa instalime që djegin mbeturinat të caktuara (mbeturinat klinike) por nuk ekziston impiant komunal për djegjen e mbeturinave. Ka gjasa të mëdha që një pjesë e madhe e mbeturinave digjet nëpër shtëpi, mirëpo kjo nuk është përfshirë dhe vlerësuar në regjistër.



Nësektori i trajtimit të ujërave të zeza përfshin emetimin e metanit nga ujërat e zeza dhe llumi i gjeneruar r nga popullata. Popullata në Kosovë prodhon pothuajse 90 mijë tonë CO₂ eq. nga kanalizimi (kryesisht i patrajtuar). Nëse trajtimi i ujërave të zeza shtohet, do të duhet të bëhet me përpjekje të kombinuara, duke përmirësuar cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe duke mos shtuar emetimet nga kjo kategori (p.sh. me anë të tërheqjes së metanit të prodhuar dhe shfrytëzimit të tij si lëndë djegëse).

